



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
01Nr 06-42507 /23
Klinë, dt 20.12 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 30.08.2023 në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkryetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe prezantoi rendin e ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;*
- 2. Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes përmirësimit të infrastrukturës;*
- 3. Kërkesë për vendosjen e shkallëve emergjente dhe pjerrinave në objekte;*
- 4. Të ndryshme.*

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Besoj që e keni lexuar dhe sipas rregullores duhet të miratohet. Nëse nuk ka dikush diçka, atëherë ju ftoj që ta ngriini dorën nëse e miratoni, të leminderit shumë!
Atëherë kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, ku fjalën e kaloj komandantit të Policisë ku e aiënderoj për angazhimin dhe kontributin që e ka në këtë Këshill.

2. Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes përmirësimit të infrastrukturës .

Komandanti, Ragip Bytyqi: Faleminderit, nënkryetare, përshëndetje për të gjithë!

Unë në pika të shkurtra i kam marr disa statistika, në këta dy muaj zonën tonë të përgjegjësishë e ka karakterizuar një fluks i madh i bashkatdhetarëve, një numër jashtëzakonisht i madh i veturave, ku rrugët në këtu në Kosovë nuk i kemi aq të përgatitura për atë numër të madh të veturave.

Gjatë muajit korrik në stacionin tonë janë paraqitur 66 raste; ndërsa në muajin gusht janë 75 raste; vepra penale në muajin korrik janë 37 raste; ndërsa në muajin gusht janë 24 raste. Ky vit kalendarik ka thyer rekord për sa i përket aksidenteve, kemi pasur numër jashtëzakonisht të madh të aksidenteve, por, për fat të mirë të gjitha aksidentet kanë qenë me dëme materiale, dhe lëndime trupore fatmirësisht me fatalitet nuk e kemi pasur asnjë rast. Në muajin korrik i kemi pasur 29 aksidente dhe në muajin gusht kanë qenë 48 aksidente; në muajin gusht kanë qenë 6 aksidente me lëndime; ndërsa në korrik 2 aksidente me lëndime; 27 janë me dëme materiale në korrik; në gusht 42 me dëme materiale. Kemi shqiptuar një numër prej 348 të gjobave në muajin korrik, kurse në muajin gusht kemi një rritje ku i kemi 690 gjoba. Muajin korrik janë arrestuar 26 persona; kurse në gusht janë 16 të arrestuar, ku 5 prej tyre janë të ndaluar. Në muajin gusht janë të konfiskuara 8 armë, kryesisht janë konfiskuar në ahengje të ndryshme, ndërsa në korrik janë konfiskuar 3 armë; gjatë gushtit janë konfiskuar 35 copë fishekë municion të ndryshëm dhe në muajin korrik rreth diku 20 fishekë.

Gjatë muajit gusht kemi pasur një rast jashtëzakonisht të ndjeshëm në zonën tonë të përgjegjësishë; është rasti i vrasjes në qendër ku fatkeqësisht ka humbur jetën një qytetar, mirëpo prej fatkeqësisë me thënë kanë pasur fat, sepse mënyra e kryerjes së vrasjes rreziku ka qenë edhe më i madh, mirëpo fatmirësisht kanë shpëtuar të tjerët. Personi i dyshuar është dorëzuar pas shumë angazhimeve tona dhe punën e ka gjykata, prokuroria, dhe besoj që së shpejti do e marr dënimin e merituar. Kurse gjatë muajit korrik kemi 3 raste të dhunës në familje; 1 lëndim trupor; 1 rast ngacmimi; përpos armëmbajtjes pa leje i kemi 3 raste të përdorimit të armës; 1 rast të personit të zhdukur por që është zgjidhur; shpërdorim i pasurisë së huaj i kemi 2 raste; 4 vjedhje dhe 3 vjedhje të rënda. Këto janë në pika të shkurtra se çka ka ndodhur gjatë këtyre dy muajve, faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, komandant, uroj që rastin që e paraqitët të jetë i fundit në komunën tonë! Gjithashtu, jam e bindur që jeni të angazhuar rreth sigurisë dhe mbarëvajtjes së sigurisë së fëmijëve tash që jemi në fillim të shtatorit dhe në komunikacion, jam shumë e sigurt që edhe si komandant por edhe si anëtar i KKS-së, do të jeni në krye të detyrës në të gjitha zonat që paraqet problem për fëmijët tanë, faleminderit shumë edhe njëherë!

Komandanti, Ragip Bytyqi: Ne vetëm e kemi të përgatitur planin operativ për fillimvitin shkollor

Bashkëpunimi ynë me institucionet shkollore dhe Drejtorinë e Arsimit nuk ka munguar asnjëherë dhe ky bashkëpunim sa vjen edhe po rritet, kështu që, unë po më mirë që ne dhe drejtori i DKA-së edhe Këshilli i prindërve kanë ndonjë pikë të caktuar ku duhet të jetë numri i patrullave me i shtuar. Është mirë me kërkuar prej nesh dhe ne aty ku e kemi mundësinë normalisht që nuk do të

hezitojmë.

Pika 2. Rritja e sigurisë së qytetarëve përmes përmirësimit të infrastrukturës .

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Paraprakisht ju kam treguar që të gjitha pikat që parashtrohen si pika të rendit të ditës janë të marra nga plani vjetor i KKSB-së.

Ne jemi munduar që në komunën e Klinës ta sigurojmë së paku aspektin e rregullimit rrugor dhe infrastrukturor, të jetë i rregulluar në mënyrën më të mirë të mundshme, por, kjo nuk do të thotë se gjithçka është e rregulluar në mënyrën perfekte, por, kemi kohë të mjaftueshme dhe aty ku kemi mbetur keq, përmes Këshillit të sigurimit të bashkësive përmes qytetarëve, dëgjimeve publike dhe formave tjera t’i identifikojmë rastet ku mundemi me ndërhyrë.

Problem nuk është vetëm te infrastruktura rrugore, kemi edhe problem tjetër; ndoshta është edhe global aspekti i vërsimeve dhe infrastrukturës ujore që ne si komunë kemi qëndruar keq sidomos në dy rastet e fundit dhe uroj që të mos ndodh më, por, asnjëherë s’jemi të sigurt se çfarë ndodh në të ardhmen, dhe nëse ju si anëtarë të KKSB-së shihni rrezik në cilëndo formë, në cilëndo pjesë të ujërave tona, ne që i kemi 6 lumenj në komunën tonë, jeni të lirë të shprehni kërkesat tuaja që ato t’i përcjellim në vendet e duhura, sepse kemi ende kohë për ndryshime në projektet tona që jemi duke i plotësuar dhe kemi kohë deri më 30 shtator.

Nëse ka ndokush lidhje me këtë temë, po Josip?

Z. Josip Dedaj: Përshëndetje për të gjithë! Unë kërkoj falje për mbledhjen e kaluar se nuk isha prezent, po kam qenë me shëndet pak keq.

Kur kemi filluar në janar e kemi theksuar që Klina nuk ka shenja të komunikacionit, në sheshet “Muji Krasniqi”, “Nue Përlleshi”, “Nënë Tereza”, shenjat nuk janë vendosur. Unë e di që tenderin e ka marr dikush, e di që është punuar diçka, po për këtë pikë të rendit të ditës, komuna e Klinës, s’ma merr mendja që ka komunë në Kosovë që është më e dobët në aspektin e nxënësve, shoferëve etj., i kam potencuar disa rrugë, sheshin “Nue Përlleshi” hyrja p.sh., nuk ka kryqëzim të rrugës, nuk ka vendosur askush shenjë aty dhe nuk ka mbledhje që nuk e kam folur, rruga e “Gjimnazit”, lagjja e “Sefermanëve” policia kanë dhënë tiketa që është rrugë një kahëshe, por kurrë shenjë nuk ka pasur.

Unë jam anëtar i komisionit, ju vet më keni vënë, por vetëm njëherë më kanë thirrur e asnjëherë më! Unë këtë problem e kam; shenjat e komunikacionit nuk janë askund në lidhje me kushtet e sotme, sidomos kësaj vere çfarë fluksi kemi pasur, çdokund keni investuar, në shenja të komunikacionit jo, faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, Josip, uroj që e keni kaluar problemin shëndetësor!

Sigurisht komandanti ka përgjigje për situatën që ti je i shqetësuar. Unë po e shfaq edhe një shqetësim të tjetër e di vet që ka të bëjë me tabelat e emërimit të rrugëve. Komuna normal që i heq të gjitha sipenzimet e tyre, por banorët e kanë hequr tabelën dhe çka është më e keqja e kanë shkëlur me traktor tabelën dhe rastin e kam lajmëruar në vendin ku duhet dhe besoj që do të shkojë tutje. Por, kjo tabelë është hequr në mënyrë vandalizuese, ndaj po them, shumë e drejtë

ajo që thash; shenjat duhet të vendosen por ndërgjegjësimi i njerëzve nuk e di më kur duhet të ndodhë dhe unë jam e shqetësuar edhe në këtë aspekt.

Komandanti, Ragip Bytyqi: Sa i përket sinjalizimit horizontal dhe vertikal, sigurisht që akoma ka ngecje, mirëpo kjo temë ka dalë prej këtij takimi këtu dhe pjesë e atij projekti punues keni qenë edhe ju si ekspert i komunikacionit, dhe policët kanë raportuar që një pjesë e sinjalizimit fazën e parë e kanë rregulluar.

Nuk është e kompletuar krejt, por, unë sa jam në dijeni, një fazë është realizuar në bazë të projektit që është punuar, ka mbetur që ti të flasësh me ata ekspertët që kanë qenë të angazhuar dhe bashkë me inxhinierët e komunikacionit ku ju keni kërkuar me urgjencë shenjat janë vendosur. Sinjalizimi akoma nuk është përfunduar, sepse përpos sinjalizimit vertikal na duhet edhe horizontal, ndërsa fluksi i madh nuk është bërë për shkak të sinjalizimit, por, sivjet ka qenë një numër enorm i automjeteve dhe rrugët në qytetin tonë nuk janë të përgatitura për një numër aq të madh të automjeteve.

Z. Josip Dedaj: Komandant, sa i përket vendosjes së shenjave është sheshi “Nue Përlleshi” ku nuk ka shenjë të kryqëzimit dhe nuk ka pasur kurrë, lagjja e “Sefermanëve” duhet të pajiset me shenjë që është rrugë një kahore. Unë vetëm një ditë jam thirrur nga Drejtoria e Inspektoratit, vetëm atë ditë kemi dalë në terren.

Komandanti, Ragip Bytyqi: Është mirë këtë projekt ta verifikojmë, pjesë e nënshkrimeve të projektit jeni edhe ju dhe nuk mund t’i ikni përgjegjësisë dhe kam kërkuar prej grupit punues se aty ku është urgjente, ju lutem, që fazën e parë ta kompletojmë, dhe nëse është ashtu si po thoni ju, që nuk është kryer, atëherë nuk është në rregull dhe unë personalisht kam menduar që është eliminuar ky problem, por, unë javën tjetër personalisht kam për t’u kujdesur që këto probleme të eliminohen.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, komandant!

Këto kërkesa kanë dalë pikërisht nga KKSB, por unë nuk jam e informuar deri ku ka shkuar situata, por kjo nuk do të thotë që nuk do të kërkoj nëse me jepet informatë dhe mos vendosja e këtyre shenjave është pasojë e gjitha aksidenteve.

Faleminderit, Josip, shpresoj që në takimin tjetër të jetë me ndryshime pozitive!

Z. Fitim Bojaj, hoxhë: Përshëndetje për të gjithë!

E the edhe ti vet, nënkryetare, kjo punë të merret me seriozitet, e kemi parë fluksin e madh të mërgimtarëve, por ka qenë shumë vështirë me qarkulluar në komunë, është bërë mirë që është bërë ndriçimi tek sheshi “Nue Përlleshi”, iniciativë e kujt ka qenë nuk e di, por ka qenë e mirë dhe kisha propozuar që edhe tek sheshi që lidh Pejën me Klinë. Kam qenë vet dëshmitar që një veturë ku kanë qenë një familje dhe janë vendosur në rreth që ka ndodhur nga mos përcjellja e shenja, por edhe mos ndriçimit. Gjithashtu, rruga që e cekim Josip, “Sefermanëve”, kisha propozuar që së paku në sezona të jetë rrugë dy kahëshe, sepse më të vërtet qarkullimi brenda qytetit ka qenë shumë i vështirë dhe këtë fluks kemi për ta pasur edhe për vitin e ri dhe mendoj që këtë punë duhet me marr me seriozitet.

Ndoshta jam më i vogli të flas këtu, por mendoj që ai shteg i biçikletave deri te ura nuk ka pasur

nevojë me u bërë hiç, por ka mundur të bëhet trakë më e gjerë për vetura.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, hoxhë, vërejtje me vend! Gjithçka u tha dhe këtu s'ka të bëjë më i vogël më i madh, të gjithë jemi të barabartë dhe çdo ide e çdonjërit nga ne është shumë e vlefshme.

Çështja e tollovisë që shkaktohet brenda komunës për shkak të rrugës është diskutuar shumë herë dhe jemi duke u munduar me bërë zgjidhje, kryetari me gjithë stafin e tij. Kaherë kemi biseduar për atë transitin e famshëm, po ende nuk po ndodh, dmth i gjithë fokusi ynë ka qenë të mos fillojmë një rrugë pa u përfunduar me prishur punën që e bëjmë, që është edhe ajo shprehja “ndërto ditën e prish natën”. Problem është te transiti, por që është diskutuar dhe që është problem. Jemi duke e parë të gjithë dhe është problem që komuna duhet me zgjidhur dhe jam e sigurt që së paku këto kërkesa do t'i çojmë në vend të duhur, është edhe shqetësim i kryetarit ku shpeshherë e ka diskutuar edhe në Bordin e drejtorëve ku marr pjesë.

Z. Josip Dedaj: Për t'i ndihmuar pak Fitimit, rrugën që e keni bërë deri te ura, ato shtylla që i keni vënë, për ato duhet me dhënë përgjegjësi dikush; më së paku janë diku 20 shtylla që janë prishur ende pa u bërë 1 vit edhe nja 7-8 janë të thyera prej aksidenteve. Në 2018-tën, kryetari më ka thënë që rruga e Dresnikut ka me u kryer dhe sot në 2023-tën jeni duke u thirrur ende në transit, kur do m'u kryer ai transit më, kur do me ja filluar më së pari? As rruga e Dresnikut nuk është e përfunduar, as transiti s'ka filluar.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, Josip! Nën një, mënyra e diskutimit të rrugës me shtylla jam e sigurt që është punuar nga njerëz kompetent dhe profesional, ndoshta për momentin duket ngushtë por është edhe pjesa tjetër që ka m'u zgjeruar dhe me u rregulluar dhe besoj shumë që ka u rregulluar.

Z. Qemajl Sejdiya, drejtor i DKA-së: Faleminderit për prezencën, përshëndetje për të gjithë, falënderoj edhe hoxhën!

Për shqetësimin që e pat, po dal pak prej temës së arsimit, por pasi që jam pjesë e Bordit dhe kemi takime vazhdimisht, rruga ka “Sefermanët” shumë shpejt do të bëhet dy kahëshe. E dimë problemin te ngushtica që nuk kemi mundur m'u kthyer dhe nuk është bërë me dëshirën e komunës, por ka qenë e vetmja zgjidhje që kemi mundur me bërë, hyrja që është bërë në qytet, mendoj që është shumë e mirë sepse ju duhet me i parë edhe anët pozitive, jo vetëm negative. Ne e shohim që ka shumë lëvizje të qytetarëve në atë pjesë me biçikleta, ne nuk duhet mohuar punët e mira që janë bërë aty, nuk është zgjidhje, ne në hyrje i bëjmë 4 traka sepse ne prapë e ngufasim qytetin dhe pozita e cila është qyteti Klinës nuk mundemi me vepruar. Është ide shumë e mirë, po që nuk mundemi me vepruar ashtu, e vetmja zgjidhje është transiti që e përfshinë pjesën kryesore me liruuar qytetin që ata që kanë nevojë me shkuar në Skenderaj a vende tjera, shkojnë përmes transinit. Ai është projekt që është përkrahur, që është ndarë buxheti, është ndaluar, nuk kemi filluar. Ajo është pjesë e nivelit qendror duke e përfshirë edhe qytetin që e përmendi hoxha që ka pasur aksidente të ndryshme, se dola pak në diçka që s'më takoi, por e pash të nevojshme me shpjeguar dhe e vetmja mënyrë me liruuar Klinën nga komunikacioni i ngarkuar është transiti. Ndërsa, sa i përket projektit të dritave, kemi shumë komuna, si p.sh., Istogu, Peja, Prishtina, që dritat janë të vendosura afër, por neve na mungon kultura, sepse besoj që shumica prej nesh kemi

udhëtuar jashtë dhe e shohim që askund s'ka të vendosura shtylla, ne duhet me vendosur shtylla për shkak se ne nuk i përshtatemi rregullave të komunikacionit, te pjesa hyrëse është bërë një punë shumë e mirë. Faleminderit!

Komandanti, Ragip Bytyqi: Sa i përket rrethrotullimit në magjistralen drejtimi i Klinës, ne s'di sa herë kemi bërë shkresa në nivel të Drejtorisë sepse atë rrugë e mbikëqyr Ministria dhe nuk është përgjegjës kuvendi komunal. Kuvendi komunal e ka bërë me pajtimin e Ministrisë së Infrastrukturës e ka punuar atë rreth që mendoj që e ka shpëtuar Klinën, sepse kolona me u inkuadruar në magjistrale ka qenë 2-3km më së paku, ne, në bashkëpunim me Ministrinë i kemi vendosur shenjat, por për shkak të pakujdesisë së veturave po i dëmtojnë. Kryetari na ka premtuar që shumë shpejt do ta vendos një shtyllë në mes të rrethrotullimit dhe është çështje e kryer sepse kjo është bërë me iniciativën e policisë, sepse kemi numër shumë të madh të aksidenteve.

Po lidhem në këtë pikë për me kursyer edhe komandantin e zjarrfikësve, ditët e fundit kemi një numër të rasteve ku kanë filluar qytetarët me djegë tokën hamullore dhe prej atyre djegieve zjarri po fillon dhe po del prej kontrollit. Unë kërkoj nga ju dhe gjithë qytetarët me pasur kujdes dhe rreptësishtë është e ndaluar ndezja e zjarreve në këtë kohë, sepse temperaturat janë shumë të larta dhe një zjarr sado i vogël mund të vije deri te pasojat shumë të rënda, e di që zjarrfikësit këto javë s'po ndalen, sa poshtë, sa lartë ndaj pakujdesisë së qytetarëve.

Don Jeton Thaqi: Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë po bashkëngjitem në këto tregime që i thanë edhe hoxha edhe Josipi, dhe tash sa erdha këtu e pash te kisha duke zbritur poshtë, që ato zebat nuk dukeshin fare dhe aty është një vend shumë i rrezikshëm, ku para 10 viteve e ka humbur jetën një fëmijë. Ka qenë ekskursion i kishës prej Prizrenit dhe aty fëmija është përplasur me një makinë që nuk ka mundur me u ndalë, kështu që, sinjalizimi duhet me qenë jo për t'u arsyetuar para nesh, por që të ndalohen shumë fatkeqësi që mund të ndodhin. Kështu që, nëse ka mundësi në atë pjesë të vendoset edhe ndonjë pasqyrë ose të ketë kontroll më të madh, dhe nuk po më duket e arsyeshme kjo ikja e përgjegjesisë, "nuk është kompetencë e komunës, por e ministrisë", por mendoj që komuna e ka mundësinë me komunikuar me qeverinë dhe me gjetur një zgjidhje.

Po më duket pak si sipërfaqësore, një nënkryetare, një drejtor dhe një komandant, me thënë se është përgjegjësi e dikujt tjetër dhe nuk mundet me u bërë.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Mund edhe të tingëllojë si ikje e përgjegjesisë, por e tha edhe komandanti, janë përgjegjësi e nivelit qendror që nuk mundesh me ndërhyrë edhe ajo pjesa e rrugës ku thua ti është pjesë që paraqet rrezik dhe ka pasur rrezik. Por, unë vet, jo në këtë pozicion që jam tash, po si drejtoresh e shkollës, kam kërkuar që në atë rrugë m'u vendosur diçka që të zvogëlohet shpejtësia dhe asnjëherë nuk më është dhënë leje, duke m'u arsyetuar që është përgjegjësi e nivelit qendror.

Z. Qemal Sejdiu, drejtor i DKA-së: Së pari të falënderoj, por në këtë është komuna me i ikë përgjegjësi! Ne në fshatin ku jetoj unë e kemi pasur rastin ku na ka marr uji dhe ne nuk kemi guxuar të intervenojmë në rrugën kryesore që është rajonale, për me liruar rrugën, disa punë nuk mund të kryhen. Unë mund të flas për në arsim e kemi kopshtin këtu te ura e Haxhisë, që 5

emaille i shkruaj, e takoj ministrin, por që ajo nuk përfundohet dhe tash nuk mund të them ty që po i iki përgjegjësisë kur ne s'kemi faj aty. Ti menaxhon diçka dhe është mirë me ditur se këto janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe s'ka të bëjë me i ikë përgjegjësisë, por është e rregulluar me rregullore dhe nuk mundesh me ndërhyrë me bërë një vijë në rrugën kryesore magjistrale, sepse nuk të lejon. Por, qytetari nuk ka faj sepse qytetari ka shpresa te shteti dhe nuk i interesojnë procedurat. Ndoshta juve ju tingëllon ashtu, por me hyrë me këqyr rregulloren se si ndahen përgjegjësit, atëherë e kupton këtë çka po them. Sa i përket rrugëve që i ka në menaxhim komuna e Klinës, të gjitha rrugët ku ka kërkesa, të gjitha janë të rregulluara me atë kapacitet që e ka komuna.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Gjithçka që shkon në dobi të qytetarëve, do të mundohemi që së paku t'i informojmë me kohë njerëzit kompetent që të dalin në vendin e ngjarjes dhe të kryejnë procedurat. Përndryshe, ju falënderoj shumë për kontributin e juaj lidhur me këtë temë!

3. Kërkesë për vendosjen e shkallëve emergjente dhe pjerrinave në objekte.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Edhe kjo është pjesë e infrastrukturës, ku çdo ditë e kemi gojën plot kur themi të gjithë duhet të jemi të barabartë në objekte dhe institucione të ndryshme. Ne jemi koshient në këtë ndërtesë se sa jemi të sigurt me vetëm një dalje, sa jemi të sigurt në projekte, ndërtesa tjera që qytetarët gjithmonë mundohen që ato probleme me i deleguar në vendin e duhur, që njerëzit me nevoja të veçanta të kenë qasje të barabartë. Synimi ynë është që çdo institucion, qoftë shkollë, qoftë QKMF, të gjitha të kenë pjerrina të domosdoshme për njerëzit me nevoja të veçanta.

Ne në komunë, vitin e kaluar kishim një projekt me të rinjtë me nevoja të veçanta dhe ata njerëz i vendosëm nëpër zyre të ndryshme me ju treguar se si është një ditë pune brenda komunës, dhe kjo komunë duke mos pasur lift, ata mbetën vetëm në katin e parë, që s'kishin mundësi të hipnin në katin e dytë dhe të tretë. Ajo që dua të them, është se si institucion duhet me na informuar, qoftë si anëtarë të KKSB-së, qoftë qytetarë, ku janë ato probleme që në të ardhmen t'i kemi të identifikuar, që mos të mbesin njerëzit me nevoja të veçanta pa qasje. Shkollat së paku e kanë të rregulluar aspektin e pjerrinave, por jo të gjitha shkollat i kanë nga dy hyrje, por këtu është problem i ndërtesave që janë bërë shumë herët dhe që tash me bërë zgjidhje është goxha problem.

Z. Elmi Zenunaj: Përhëndetje për të pranishmit, ju përgëzoj për këtë iniciativë!

Në rend të ditës është kërkesë për vendosjen e shkallëve, kisha dashur të di, kush e ka bërë kërkesën në këtë rast dhe pse asnjë objekt në komunën e Klinës nuk ka shkallë emergjente, a është niveli i përdorur edhe këtu fajtor?

Çdo shkollë e ndërtuar pas luftës është me një hyrje, gjimnazi i vjetër është i ndërtuar me dy hyrje, amfiteatri i vjetër i ka dy hyrje, gjitha i kanë nga dy hyrje, por të gjitha që janë të ndërtuara pas luftës janë me një hyrje dhe shkallët emergjente neve na kishin ndihmuar shumë në intervenime.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit i nderuar, por unë nuk jam kompetente të flas për profesionalizmin e ndërtimeve të inxhinierëve dhe projekteve të tilla, mundem vetëm të ndjej keqardhje dhe të presim me u përmirësuar (prapë kjo nuk është ikje e përgjegjësisë). Prapë kur thatë shkallët emergjente, faktikisht unë e potencova edhe në fillim, të gjitha pikat e rendit të ditës unë i marr nga plani që e kemi punuar më herët dhe nxjerr tema të cilat duhet me u trajtuar dhe m'u rregulluar.

Nëse jemi shëndosh dhe jemi prapë bashkë vitin tjetër, kur të përpilohet plani për siguri dhe bashkësi, ata që dëshirojnë të jenë pjesë e punës, nuk e di se si është rregullorja, por unë kam me ju ftuar nëse ju keni kohë të lirë, t'i bëjmë temat bashkë, sepse neve nuk na vyen me nxjerrë tema me të cilat unë isha krenuar për punët e mira që janë bërë, por na duhet me nxjerr tema ku është problemi në komunën tonë, në mënyrë që t'i përmirësojmë e këtu hyjnë edhe shkallët emergjente.

Z. Fitim Bojaj, hoxhë: Këtu jemi bartës të institucioneve dhe s'jemi pozitivë - opozitivë, të gjithë mundohemi për të mirën e vendit dhe ju mos na merrni që ne po ju akuzojmë juve, por po bashkëpunojmë për një të ardhme sa më të mirë për qytetin e Klinës.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, hoxhë, unë jam bashkë me juve pjesë e qytetarëve dhe jemi duke u munduar me bërë më të mirën për qytetarët! KKSB-ja i ka të gjitha institucionet bashkë që e përbëjnë një komunitet të përbashkët, ku në udhëheqje të saj jam unë si nënkryetare, ku besoj që po të mos ishte aq i ngarkuar sa është kryetari, do t'ju përgjigjej me përgjigjet e duhura. Por, unë me përgjegjësi të plotë e them se unë asnjëherë nuk e marr asnjë situatë me hatërmbetje, pos që jam munduar me ju dhanë përgjigjen e duhur dhe kur s'kam pasur përgjigje ju kam thënë se ju përgjigjem në seancën e ardhshme, dhe gjithçka çka del nga ky Këshill del për të mirën e qytetarëve. Unë e shoh me respekt shumë të madh takimin me ju dhe mundohem të jem përgjegjëse.

4. Të ndryshme.

Z. Josip Dedaj: Nënkryetare, unë po e shoh një pikë të rëndësishme në mbledhjen e kaluar që nuk kemi folur më herët: "Ruajtja e ambientit dhe iniciativa që duhet marr". Unë prita nga ti dhe komandanti i policisë me dhanë një informacion shumë të këndshëm për ne anëtarët dhe gjithë qytetarët e Klinës, po i cekim vetëm dy: protesta gjithë popullorë që duhet me i falënderuar qytetarët e Klinës që kanë qenë shumë të kulturuar dhe shumë frytdhënëse, më 14.05.2022 te kisha e Dollcit ku e kemi pasur protestën, e din komandanti, dhe më 24.07.2023 para kuvendit komunal. Komandanti s'ka qenë këtu, ka qenë në pushim më duket, që ne i kemi pasur disa probleme edhe nga ana e policisë edhe nga ana e drejtorisë, por si dukudo ka shkuar në mënyrë të mirë të mundshme. Si iniciativë për ndalimin e fabrikës së çimentos, jemi duke protestuar që prej 2012-tës po atë ditë kemi qenë nga 2020-ta, gjykata e apeloire në Prishtinë i ka ndaluar të gjitha rregullimin e dokumenteve për rregullimin e fabrikës dhe që fabrikë nuk ka. Ne jemi ballafaquar disa herë edhe me ekskavatorë që dilnin e punonin, por gjithmonë kemi gjetur

mirëkuptimin, s'ka pasur incidente, këtë është dashur ti ose komandanti në fillim për hir të anëtarëve të KKSB-së, ta cekni.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, Josip! Unë e kam përcjellë me vëmendje rastin, e kam parë që qytetarët e kanë fituar të drejtën e tyre. S'di sa ke qenë i vëmendshëm në fillim kur e thash, unë gjithmonë e them atë çka mendoj dhe e besoj deri më sot askush nuk ka kërkuar mendimin tim çka mendoj për fabrikën, sepse kuptohet ne kemi një kryetar, një grup njerëzish që e kanë menduar gjatë. Kanë qenë qytetarët ata që e kanë refuzuar, e kanë kundërshtuar dhe unë gjithmonë jam adhuruese e natyrës, unë mendimet e mija i kam dhe më vjen mirë që nuk është realizuar kjo fabrikë sipas asaj që u thanë e dëmshme sa i përket ndotjes së natyrës.

Në radio "Alba" e kam thënë para të gjithë qytetarëve, nuk mund t'i iki asaj çka e them dhe e mendoj: Një shtet, një komunë, nuk e di si ka me funksionuar pa fabrika. Për të ardhmen, të gjithë qytetarët e Klinës ishte dashur të ngrihen bashkë me kërkuar ndërtimin e fabrikës e cila ndërtohet me standarde të larta, që nuk e ndot ambientin, që na i mban të rinjtë afër në këtë qytetin tonë që hap vende të reja pune. Unë s'kam parë shtet as komunë që rigjeneron vende të punës pa fabrika. Më mirë të kërkon cilësi, se sa mos me u ndërtuar.

Komandanti, Ragip Bytyqi: Unë, zëdhënës i gjykatës nuk jam, Josip!

Z. Josip Dedaj: Kur kemi pasur problem me ekskavator, na ke thirrur në zyre, për të pirë kafe.

Komandanti, Ragip Bytyqi: Disa kompetenca i kemi të ndara dhe unë vetëm nga mediat e kam marr informacionin që është marr një vendim. Çka është marr ai vendim, neve aspak nuk na intereson, sepse ne jemi për siguri, dhe kur ju kemi thirrur, ju kemi thirrur për siguri dhe po më duket që kjo është pak e qëllimshme dhe kemi dal pak prej teme.

Z. Qemajl Sejdija, drejtor i DKA-së: Ai është vendim i asamblesë, vendimi i anulimit është bazuar në vendimin e asamblesë së komunës së Klinës. Gjykata ka marr vendim në bazë të vendimit që është sjell këtu në kuvend, vetëm për me e ditur se është vendim i asamblistëve të komunës së Klinës.

Nënkryetarja mbylli takimin duke i përshëndetur të gjithë dhe duke i falënderuar për prezencë secilin.

Procesmbajtësa,

Orgeta Syllaj

